



KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në bazë të nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-139,për Shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205,dhe Nenit 97 të Ligjit për procedurën administrative nr.05/L-031,të Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit, komentimit dhe intervestimit të palëve,brenda afatit ligjor, Kryetari i Komunës së Gjakovës, mori këtë :

VENDIM PËRFUNDIMTAR

1.APROVOHET kërkesa e subjektit kërkuar, Komunës së Gjakovës, iniciuar nga Shkolla fillore “Zekerija Rexha” nga Gjakova Rr.“N,Tereze” nr.75, për shpronësimin për interesin publik, të objektit banesorë, e cila ndodhet në oborrin e shkollës fillore “Zekerija Rexha”, e qëllimi për të cilën shpronësohet ka të bëjë me lirimin e një pjese të hapësirës në oborrin e kësaj shkolle, për pronën nr.67,Z.K.Gjakovë-qytet cila sipas tabelës i bashkëngjitet këtij Vendimi, dhe për të cilën do të bëhet kompensimi i saj .

2. Pas nënshkrimit të këtij Vendimi përfundimtar brenda 5 (pesë) ditëve të punës, i njëjti i dërgohet subjektit kërkuar dhe personit të identifikuar në tabelën e përcaktuar si në piken I të këtij Vendimi.

3. Brenda 10 ditëve (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi , i njëjti do të shpallet në gazetën zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazete me tirazh më të madh në Kosovë.

4.Kunder këtij Vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit subjekti kërkuar, secili person që është pronar ose zotëruar i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht a është i identifikuar apo jo në tabelën e bashkëngjitur këtij vendimi.

5.Vendimi hynë në fuqi me datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.



Vendimi iu dërgohet:

- Kabinetit të Kryetarit;
- Shërbimi profesional të Kuvendit të Komunës;
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër e Pronë;
- Drejtorisë për Arsimit
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Departamenti i Tatimit në Pronë

Komuna: Gjakovë Zona Kadastrale: Gjakovë Qytet									
Të dhënat sipas Elaboratit / Fletës Poseduese						Vlerësimi			
Nr.	Pronar	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për servitut m ²	Çmimi i tokës (€ /m ²)	Vlera për dru pyjor dhe frutor (€)	Vlera e Investimit (€)	Totali (€)
1	PSH SHKOLLA FILLORE ZEKRIJA REXHA	67						16,513.80	16,513.80
Totali									16,513.80

